

## Shërbimet e "RIKU" janë për ty nëse

- Je ose dyshoni se je viktimë e krimit
- Një i afërm i yti ka rënë viktimë e krimit
- Je dëshmitar në lëndë penale
- Ke nevojë për t'u këshilluar dhe për të biseduar rreth përvojave tua
- Si profesionist dëshiron këshilla për të mbështetur klientin tënd

Mund të na kontaktosh me telefon ose në internet – edhe në formë anonime. Mund të kërkoksh gjithashtu edhe takim ballë për ballë në zyrat tona.



"RIKU" nuk është organ qeveritar, por një OJQ pa përkatësi politike apo fetare. "RIKU" mbështetë në besim të plotë viktimat e krimit. Pa lejen tënde askujt nuk i jepen informacione rreth teje.

## Shërbimet e "RIKU" janë edhe për viktimat e shfrytëzimit ose të tregtisë me njerëz

• A kontrollon dikush (p.sh. ndonjë i afërm, punëdhënësi, bashkëshorti) lëvizjet tua ose kontaktet tua me njerëz tjerë? • A të kanë thënë se ke borxh për ardhjen tënde në Finlandë? • A frikohesh se ty ose të afërmeve tuaj do t'ju ndodhë ndonjë e keqe nëse ti ke mosmarrëveshje me punëdhënësin tënd? • A punon falas ose a merr aq pak rrogë nga puna jote sa që nuk të mjafton për gjërat themelore jetësore? • A të kanë premtuar rrogë më të madhe se sa në të vërtetë merr? • A detyrohesh të punosh mbi 10 orë pothuajse çdo ditë? • A të kanë premtuar punë tjetër lloji nga ajo që ti detyrohesh të bësh? • A të kanë frikësuar ty se do të të largojnë nga Finlanda ose do ta humbësh lejen e qëndrimit? • A po të detyron ose kërkon dikush nga ti që të bësh ndonjë gjë kriminale ose diç tjetër që nuk dëshiron të bësh? • A po frikohesh të bisedosh për gjendjen tënde?

Nëse ti ose ndonjë i afërm i yti ka përjetuar ndonjë nga këto gjëra, kontakto zyrën më të afërme të "RIKU"-t ose dërgo e-mail në adresën [help@riku.fi](mailto:help@riku.fi). Të gjitha bisedat telefonike dhe e-mailat i trajtojmë në mënyrë të besueshme dhe ato nuk i dërgohen askujt pa lejen tënde.

# RIKU

RIKOSUHRIPÄIVYSTYS

"Mbështetja për Viktimat e Finlandës (RIKU)" udhëzon dhe mbështetë viktimat e krimeve, të afërmit e tyre dhe dëshmitarët e krimeve



ME TELEFON



NË INTERNET



BALLË PËR BALLË



ME TELEFON



NË INTERNET



MBËSHTETJE PERSONALE  
NË ZYRAT TONA



### Linja kombëtare e ndihmës

(kryesisht në finlandisht)

**116006**

E hënë - E martë, ora 13:00-21:00  
dhe E mërkurë - E premte, ora  
17:00-21:00



### Linja kombëtare e këshillimit

**ligjor** (në finlandisht)

**0800-161177**

E hënë - E enjte, ora 17:00-19:00



### Zyrat e "RIKU"

Zyrat tona anembanë Finlandës ofrojnë mbështetje dhe shërbime këshillimore. Kontrolllo informacionet e tyre të kontaktit në faqen [www.riku.fi](http://www.riku.fi)



Në shërbimin tonë në internet, RIKUchat, mund të shtrosh pyetje dhe të këshillohesh drejtpërdrejt, madje edhe në mënyrë anonime. Ky shërbim gjendet në adresën [www.riku.fi](http://www.riku.fi)



Faqja e "RIKU" në internet në adresën [www.riku.fi](http://www.riku.fi) ofron me bollëk informacione shtesë. Informacionet bazë jepen në 20 gjuhë të ndryshme.



Zyrat e "RIKU" anembanë Finlandës ofrojnë mbështetje **pa pagesë** për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve. Gjithnjë mund të përdorim përkthyes të besueshëm, i cili është i obliguar të mbajë sekretin. Informacionet e kontaktit të zyrës që ke më pranë mund t'i gjesh në adresën [www.riku.fi](http://www.riku.fi) në internet.



Nëpërmjet zyrës sonë mund të pyesësh për një person të mbështetjes, me të cilin mund të takohesh dhe të flasësh në besë. Personi i mbështetjes të dëgjon dhe të ofron këshilla praktike, si dhe mund të vijë me ty nëse e fton në intervistë në polici ose në gjykatë.



/rikosuhripaivystys



@rikosuhrit